



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 46

2002

Gusht

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.49, datë 25.7.2002	Për pranimin e dekretit të presidentit nr.3358, datë 3.6.2002 “Për kthimin e ligjit nr.8893, datë 14.5.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.7.1998”....	1355
Vendim i Kuvendit nr. 50, datë 29.7.2002	Për zgjatjen e afatit të punës së Komisionit Parlamentar Bipartizan për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-SË/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001....	1355
Vendim i Kuvendit nr. 51, datë 29.7.2002	Për zgjatjen e afatit të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për shqyrtimin e projektligjeve të paraqitura në Kuvend për problemet e pronave.....	1356
Vendim i Kuvendit nr. 52, datë 31.7.2002	Për krijimin e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e akuzave lidhur me veprimtarinë e Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Drejtorit të tij, zotit Fatos Klosi.....	1357

Vendim i Kuvendit Nr. 53, datë 31.7.2002	Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave.....	1358
Vendim i KM nr. 361, datë 18.7.2002	Për miratimin e aneksit shtesë të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore.....	1359
Vendim i KM nr. 364, datë 18.7.2002	Për miratimin e planit "Administrimi i zonës bregdetare" .....	1363
Vendim i KM nr. 366, datë 18.7.2002	Për shfuqizimin e vendimit nr.412, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave "Për shfuqizimin e vendimit nr.367, datë 5.10.1991, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes me Republikën e Italisë, në fushën e turizmit dhe mjedisit" .....	1363
Vendim i KM nr. 369, datë 23.7.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve", me ndryshimet përkatëse dhe në vendimin 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse.....	1364
Vendim i KM nr. 370, datë 23.7.2002	Për trajtimin financiar të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura, që dërgohen për studime e specializim brenda dhe jashtë vendit.....	1365
Vendim i KM nr. 371, datë 23.7.2002	Për hapjen e fakultetit ekonomik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në Elbasan, duke filluar nga viti akademik 2002-2003.....	1366
Vendim i KM nr. 374, datë 23.7.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Cërrikut.....	1366
Vendim i KM nr. 375, datë 23.7.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me vendimin nr.278, datë 20.6.2002 të Këshillit të Ministrave.....	1367
Vendim i KM nr. 376, datë 23.7.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.406, datë 17.8.1993 të Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e shërbimit të mbrojtjes së bimëve", ndryshuar me vendimin nr.9, datë 12.1.2001 të Këshillit të Ministrave.....	1368
Vendim i KM nr. 382, datë 23.7.2002	Për shkëmbimin e të dhënave në fushën e standardeve dhe të rregullave teknike.....	1369

**VENDIM**  
**Nr. 49, datë 25.7.2002**

**PËR PRANIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT NR.3358, DATË 3.6.2002 “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR.8893, DATË 14.5.2002 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8269, DATË 23.12.1997 “PËR BANKËN E SHQIPËRISË””, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8384, DATË 29.7.1998”**

Në mbështetje të nenit 85 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Pranohet dekreti nr.3358, datë 3.6.2002 “Për kthimin e ligjit nr.8893, datë 14.5.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.7.1998” për rishqyrtimin e ligjit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 50, datë 29.7.2002**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË PUNËS SË KOMISIONIT PARLAMENTAR BIPARTIZAN PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 2001**

Në mbështetje të neneve 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit Parlamentar Bipartizan (pozitë-opozitë) për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zgjatet afati i punës së Komisionit Parlamentar Bipartizan (pozitë-opozitë) për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve në Raportin Përfundimtar të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit 2001, deri më 31.12.2002.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 51, datë 29.7.2002**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË PUNËS SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR  
PËR SHQYRTIMIN E PROJEKTLIGJEVE TË PARAQITURA NË KUVEND PËR  
PROBLEMET E PRONAVE**

Në mbështetje të neneve 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të posaçëm parlamentar për shqyrtimin e projektligjeve të paraqitura në Kuvend për problemet e pronave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zgjatet afati i punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për shqyrtimin e projektligjeve të paraqitura në Kuvend për problemet e pronave, deri më 30.11.2002.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 52, datë 31.7.2002**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E AKUZAVE  
LIDHUR ME VEPRIMTARINË E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT DHE TË  
DREJTORIT TË TIJ, ZOTIT FATOS KLOSI**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 e 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 3, 5 pika 1, 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Krijohet Komisioni Hetimor i Kuvendit për hetimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të akuzave publike për veprimtarinë e këtij institucioni, si dhe të Drejtorit të tij, zotit Fatos Klosi.

II. Komisioni Hetimor i Kuvendit ka për qëllim dhe objekt veprimtarie hetimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Drejtorit të tij, zotit Fatos Klosi, në mënyrë të veçantë të akuzave të paraqitura në seancën debat të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e mbajtur me Kryeministrin më datë 2.5.2002.

III. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë prej të cilëve 5 nga partitë e pozitës dhe 4 nga partitë e opozitës.

IV. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Spartak Ngjela	PD	Kryetar
2. Bashkim Fino	PS	Nënkryetar
3. Maksut Balla	PS	Anëtar
4. Mustafa Muçi	PS	Anëtar
5. Gazmir Bizhga	PS	Anëtar
6. Albert Çaçi	PS	Anëtar
7. Fatos Beja	PD	Anëtar
8. Edi Paloka	PD	Anëtar
9. Robert Çeku	PR	Anëtar

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej tre muajsh nga data e miratimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 53, datë 31.7.2002**

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES DHE PROGRAMIT POLITIK**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 96 dhe 97 të Kushtetutës, bazuar në dekretet e Presidentit të Republikës nr.3415, datë 25.7.2002 “Për emërimin e Kryeministrit” dhe nr.3416, datë 29.7.2002 “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet përbërja e Këshillit të Ministrave si më poshtë:

1. Fatos Nano	Kryeministër
2. Ilir Meta	Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme
3. Luan Rama	Ministër i Rendit Publik
4. Pandeli Majko	Ministër i Mbrojtjes
5. Kastriot Islami	Ministër i Financave
6. Arben Malaj	Ministër i Ekonomisë
7. Spiro Peçi	Ministër i Drejtësisë
8. Viktor Doda	Ministër i Industrisë dhe Energjetikës
9. Besnik Dervishi	Ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
10. Spartak Poçi	Ministër i Transportit dhe Telekomunikacioneve
11. Luan Memushi	Ministër i Arsimit dhe Shkencës
12. Mustafa Xhani	Ministër i Shëndetësisë
13. Ben Blushi	Ministër i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
14. Valentina Leskaj	Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale
15. Agron Duka	Ministër i Bujqësisë dhe Ushqimit

16. Arta Dade	Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
17. Lufter Xhuveli	Ministër i Mjedisit
18. Sokol Nako	Ministër Shteti për Integrimin
19. Blendi Klosi	Ministër Shteti pranë Kryeministrit

II. Miratohet Programi Politik i Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Servet Pëllumbi**

**VENDIM  
Nr. 361, datë 18.7.2002**

**PËR MIRATIMIN E ANEKSIT SHITESË TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË LUFTËS  
KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 102 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e aneksit shtesë të strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e detyrave, të përcaktuara në këtë aneks shtesë.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko**

Aneks shtesë

**HYRJE**

Shqipëria është porta e hyrjes dhe daljes nga Ballkani e hapur krejtësisht si për lëvizjet ilegale drejt lindjes, ashtu dhe për ato drejt perëndimit të njerëzve, armëve, mallrave dhe drogave kontrabandë. Mungesa e unitetit dhe komunikimit mes policisë kufitare, doganave, policisë kriminale dhe sistemit gjyqësor shqiptar i kanë lënë kufijtë e Shqipërisë të pambrojtur e të depërtueshëm; trafikantët rrallë ndiqen penalisht. Terroristët dhe trafikantët kanë fitime nga kjo tregti e paligjshme dhe kanë përfituar nga situata. Ndalimi dhe ndjekja penale janë faktorë kyç në eliminimin e të qenurit të Shqipërisë një vend kryesor tranziti.

Qeveria e Shqipërisë ka filluar të shfaqë vullnetin politik për përballimin e problemeve të saj nëpërmjet zhvillimit të një strategjie kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, por i mungojnë burimet dhe ekspertiza për ta zbatuar këtë plan.

Donatorët, me programe asistence në mbështetje të aftësive në rritje të Shqipërisë në fushën e zbatimit të ligjit, kanë krijuar së bashku një konsortium ndërkombëtar në Tiranë, një grup informal të përbërë prej 25 organizata ndërkombëtare dhe ambasada që punojnë aktivisht në programe të asistencës antitrafik. Anëtarë të Konsortiumit Ndërkombëtar janë gjithashtu dhe Ministria e Rendit Publik, Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Konsortiumi ka filluar bashkërendimin, racionalizimin dhe bashkëveprimin e përpjekjeve për asistencë antitrafik. Gjithashtu, ka provuar se mund të ketë një bashkëpunim të ngushtë mes donatorëve dhe zyrtarëve të Qeverisë Shqiptare.

## PROPOZIMI

Për të mbështetur më tej Strategjinë Shqiptare për Antitrafikun dhe bazuar mbi bashkëpunimin e sipërpërmendur mes Qeverisë Shqiptare dhe anëtarëve të tjerë të Konsortiumit Ndërkombëtar, disa nga anëtarët e Konsortiumit Ndërkombëtar propozojnë që një qëllim i menjëhershëm duhet të ishte një kontroll më efikas i tri pikave më të mëdha të hyrje-daljes: Rinasit, Durrësit dhe Vlorës. Kjo do të arrihej duke vendosur ekspertë ndërkombëtarë për të këshilluar zyrtarët shqiptarë në fushën e zbatimit të ligjit pranë këtyre tri lokaliteteve. Ky bashkëpunim do të forconte masat për sigurinë dhe antitrafikun, duke çuar operacionet në standarde ndërkombëtare. Ekspertët e policisë për krimin dhe antitrafikun pranë Konsortiumit besojnë se, nëse mund të forcojmë kontrollet në Aeroportin e Rinasit, Aeroporti i vetëm civil dhe ndërkombëtar i Shqipërisë, si dhe në portet e Durrësit dhe Vlorës në Adriatik, qendrat kryesore të Shqipërisë për import-eksport, ne mund të dëmtojmë seriozisht të gjitha llojet e trafikimit, duke i detyruar trafikantët dhe terroristët të braktisin linjat e tyre nëpërmjet Shqipërisë. Anëtarët e Konsortiumit besojnë se kjo mund të fillohet së shpejti duke vepruar së bashku nëpërmjet Konsortiumit.

## STRATEGJIA

Anëtarët propozojnë një strategji të plotë 3-vjeçare për të luftuar trafikimin. Të gjithë tani i kuptojnë lidhjet politike të trafikimit, terrorizmit dhe krimit të organizuar. Propozimi ynë ka për qëllim të ndërpresë shumicën e lëvizjeve të paligjshme të njerëzve, armëve dhe drogës. Mënyra për ta bërë këtë është duke dhënë ekspertizë teknike dhe pajisje për të ndihmuar policinë shqiptare dhe të tjerët në punën e tyre për të kontrolluar më me efikasitet tre pikat e hyrje-daljes në Shqipëri, si dhe për t'i çuar operacionet dhe sigurinë në standardet ndërkombëtare.

Strategjia parashikon krijimin e një konsortiumi ndërkombëtar prej të paktën 6 këshilltarësh në secilin prej 3 lokaliteteve për një vit. Këshilltarët do të ndihmonin kolegët e tyre shqiptarë për të monitoruar çdo anë të operacioneve, duke i vënë theksin zhvillimit të aparateve të duhura për sigurinë, procedurave, rrjeteve të informacionit dhe ambienteve për të filluar t'i çojmë ato drejt standardeve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, Konsortiumi do të ndërmernte programe të gjera trajnimi për nivele të ndryshme personeli në secilin prej tre porteve. Gjatë vitit të dytë e të tretë monitorimi dhe trajnimi do të vazhdonin. Qëllimi do të ishte që shqiptarët, pa ndihmë ndërkombëtare, të jenë në gjendje të kenë masa sigurie dhe procedura të pranuar ndërkombëtare brenda fundit të vitit të tretë.

Gjatë këtij projekti Anëtarët:

- do të krijojnë një Konsortium Ndërkombëtar Këshilltarësh për të ndihmuar Shqipërinë të kontrollojë më me efikasitet tre pikat kryesore të hyrje-daljes në Shqipëri;
- do të sigurojnë pajisjet e nevojshme për shërbimin e kontrollit të kufirit për aeroportin dhe portet detare;
- do të sigurojnë këshillim, bazë teknike dhe menaxherial për policinë, kontrollin e kufirit/doganat, zyrën e emigracionit dhe autoritete të tjera në pikat e hyrjes;
- do të sigurojnë trajnimin e nevojshëm bazë dhe të përparuar për policinë e kufirit, doganat e të tjerë të përfshirë në sigurinë e pikave të hyrjes.

## KËRKESAT PËR BURIMET

### a) Personeli

Çdo pikë hyrje, Rinasi, Durrësi e Vlora, do të kenë gjashtë këshilltarë/monitorues të caktuar nga Konsortiumi Ndërkombëtar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë fondet për dy këshilltarë amerikanë për secilin nga tre pikat e hyrje-daljes (gjithsej 6), ndërsa 12 këshilltarët e tjerë do të sigurohen nga anëtarët e tjerë të Konsortiumit, si Qeveria Italiane, Greke, Gjermane, Angelze, Kanadeze apo Turke dhe/apo nga Bashkimi Evropian, OSBE-ja dhe Misioni i Asistencës së Doganave të BE-së.

Shtetet e Bashkuara janë angazhuar të sigurojnë dy këshilltarë në çdo port, si edhe një këshilltar në Qendrën e Antitrafikut në Vlorë. Pjesa e programit që i takonte SHBA-së tashmë është financuar plotësisht. Lista e propozuar e detyrave dhe vendeve të këshilltarëve ndërkombëtarë është siguruar si më poshtë:

#### LISTA E PROPOZUAR KËSHILLIMORE E KONSORTIUMIT NDËRKOMBËTAR

Aeroporti Ndër.Rinas	Këshilltar dhurues	Autoriteti i Portit të Durrësit	Këshilltar dhurues	Autoriteti i Portit të Vlorës	Këshilltar dhurues
Ekzaminimi i pasaportës/vizës	USINS	Ekzaminimi i pasaportës/vizës	Itali/Greqi	QAT/analiza/përpunimi i të dhënave	ICITAP
Teknologjia e informacionit (IT)/analiza/përpunimi i të dhënave	ICITAP	Analiza e të dhënave/përpunimi & menaxhimi i IT	ICITAP	QAT/Koordinimi i operacioneve	BE
Trajtimi i doganave & inspektimi i ngarkesave	BE	Trajtimi i doganave & inspektimi i ngarkesave	BE	Ekzaminimi i pasaportës/vizës	Itali/Greqi
Sigurimi i pasagjerëve/bagazheve	Turqi OSBE	Ndalimi i anijeve/ekuipezheve	Itali & SHBA	Trajtimi i doganave & inspektimi i ngarkesave	BE
Sigurimi i perimetrit të aeroportit & i lejimit	BE	Këshilltari i sigurimit të përgjithshëm	SHBA	Këshilltar i sigurimit të përgjithshëm	SHBA
Koordinimi/kontrolli i policisë kufitare & doganore/kontrolli i pasaportave	BE	Koordinimi/kontrolli i policisë kufitare & doganore/kontrolli i pasaportave	BE	Ndalimi i anijeve/ekuipezheve koordinimi/kontrolli	Itali & SHBA BE
Totali i këshilltarëve të Rinasit	6	Totali i këshilltarëve të Durrësit	6	Totali i këshilltarëve të Vlorës	7

#### b) Trainimet

Anëtarët e Konsortiumit Ndërkombëtar do të sigurojnë trajnime të plota për policinë kufitare, punonjësit e doganave dhe personelin e kontrollit të pasaportave dhe të tjerë që punojnë në portet e Rinasit, Durrësit dhe Vlorës. Trainimet do të përqendrohen në aspektet teknike, si edhe drejtuese të kontrollit të fluksit të njerëzve dhe të mallrave që hyjnë dhe dalin nga vendi.

Kurset e trainimeve të ofruara mund të përfshijnë të mëposhtmet:

- identifikimin e dokumentave mashtruese dhe false;
- teknikat e survejimit;
- teknikat e inspektimit të ngarkesave;
- profilizimi kriminal/psikologjik;
- teknikat e ndalimit;
- menaxhimi i kompjuterizuar i pasaportave /vizave/doganave.

## TEKNIKAT E ANTITRAFIKUT

### c) Paisjet

Aeroporti Ndërkombëtar i Rinasit është një aeroport i vogël me kushte minimale ekzistence. Ky aeroport nuk ka një perimetër sigurie dhe i mungon ndriçimi i duhur, rrethimi, dyert e hyrjes, ambientet e bagazheve dhe të pritjes dhe ambientet e nevojshme të ruajtjes së ngarkesave. Përveç këtij propozimi, do të ishte me vlerë që të ndërmerrej një studim fizibiliteti për ndërtimin e një aeroporti të ri që plotëson standardet e komfortit, sigurisë dhe ruajtjes ndërkombëtare. Ndërkohë, pajisje të veçanta nevojiten urgjentisht për ta bërë aeroportin më të sigurt.

Portet detare të Durrësit dhe Vlorës janë portat më të mëdha të hyrjes dhe të nisjes për pjesën më të madhe të njerëzve dhe mallrave. Sigurimi ndahet midis Policisë Kufitare dhe agjentëve doganorë. Guardia Di Financa Italiane (Policia Tatimore) dhe Interforca, gjithashtu, punojnë nga portet. Megjithatë, me gjithë mbulimin adekuat në dukje të policisë, një përqindje e konsiderueshme e trafikut dhe kontrabandës së paligjshme realizohet nëpërmjet këtyre porteve. Pajisjet e nevojshme për sigurim duhen për të dy portet.

Ne propozojmë që të sigurojmë pajisje për sigurim, monitorim, survejim dhe inspektim në portet e Rinasit, Durrësit dhe Vlorës që do të përdoren nga zyrtarë shqiptarë me njohuri teknike të siguruar nga këshilltarët e Konsortiumit Ndërkombëtar. Një listë e sugjeruar e pajisjeve që do të sigurohet është renditur në tabelën e mëposhtme:

### LISTA E PAJISJEVE TË KËRKUARA

Nr.	Përshkrimi i artikujve	Kosto për njësi	Sasia	Kosto totali
1	Viza elektronike & pajisje për kontrollin e pasaportës	2,000	3	6,000
2	Pajisjet e interceptimit të radiove	5,000	3	15,000
3	Pajisje për pamje natën	2,000	6	12,000
4	Makinë me rreze X (për inspektim ngarkese)	50,000	3	150,000
5	Sistemi i survejimit me video (me regjistrim 72 orësh)	25,000	3	75,000
6	Kompjuter laptop me printer portable	3,000	6	18,000
7	Pajisje për lidhjen e kompjuterave me internet pa kabëll	1,200	6	7,200
8	Celular	200	6	1,200
9	Kartë SIMM për telefonat	400	6	2,400
10	Faturat e telefonatave me celular	1,200	6	7,200
11	Makina 4 x 4	28,000	3	84,000
12	Karburant për makina	2,400	3	7,200
13	Mirëmbajtje për makina	600	3	1,800
Kosto totale e paisjeve				\$ 537,000

### MBËSHTETJA

Konsortiumi Ndërkombëtar do të ndërmarrë programe të gjera trajnimi për nivele të ndryshme stafi në secilin prej tre porteve, në mënyrë të tillë që autoritetet e kontrollit të kufirit shqiptar të jenë të afta të ndërmarrin masa sigurie dhe procedura të pranuar ndërkombëtare brenda fundit të vitit të parë. Gjatë dy viteve të mëpasshme, qëllimi do të ishte t'i bënte shqiptarët të ruajnë standarde ndërkombëtare, me këshilltarët ndërkombëtarë që monitorojnë dhe këshillojnë në mënyrë të vazhdueshme zyrtarët shqiptarë sipas kërkesave dhe nevojave.

**VENDIM**  
**Nr. 364, datë 18.7.2002**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT "ADMINISTRIMI I ZONËS BREGDETARE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 52 të ligjit nr.7664, datë 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit "Administrimi i zonës bregdetare", i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë dhe këshillat e rregullimit të territorit, në nivel vendor, në vendimmarrjet, të mbajnë parasysh kërkesat dhe rekomandimet e planit "Administrimi i zonës bregdetare".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 366, datë 18.7.2002**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.412, DATË 22.8.1994 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.367, DATË 5.10.1991 TË**  
**KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME REPUBLIKËN**  
**E ITALISË NË FUSHËN E TURIZMIT DHE MJEDISIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 121 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shfuqizimin e vendimit nr.412, datë 22.8.1994 të Këshillit të Ministrave "Për shfuqizimin e vendimit nr.367, datë 5.10.1991 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e marrëveshjes me Republikën e Italisë në fushën e turizmit dhe mjedisit" dhe lënien në fuqi të vendimit nr.367, datë 5.10.1991 të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 369, datë 23.7.2002**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE DHE NË VENDIMIN 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 4, shtesa për vështirësi vendi e shërbimi, të lidhjes "Shtesat mbi pagën bazë për ushtarakët aktivë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes", të bëhet "deri në 35 për qind të pagës mujore".

b) Në pikën 2, paga e ushtarëve dhe studentëve ushtarakë të bëhet deri 1 165 (një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

c) Paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	112 500 lekë
- Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	94 500 lekë
- Komandant i Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare	94 500 lekë
- Komandant i Doktrinave dhe Stërvitjes	80 000 lekë
- Komandant i Komandës Logjistike	80 000 lekë
- Drejtor drejtorie	73 000 lekë

Për këto funksione nuk zbatohet shtesa për natyrë të veçantë pune.

2. Në pikën 20 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, masa e shtesës për natyrë të veçantë pune, që përfitojnë punonjësit civilë, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes të bëhet "deri në 35 për qind".

3. Efektet financiare prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh në muaj, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2002.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 370, datë 23.7.2002**

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË**  
**ARMATOSURA, QË DËRGOHEN PËR STUDIME E SPECIALIZIM BRENDA DHE**  
**JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që dërgohen për studime dhe specializim në institucionet arsimore brenda vendit përfitojnë pagë, për periudhat respektive, në masën si më poshtë vijon:

a) deri në 6 (gjashtë) muaj, pa shkëputje nga puna, pagën e plotë për funksion (gradë);

b) më shumë se 6 (gjashtë) muaj, me shkëputje nga puna, pagën për funksion (gradë) që ka patur në çastin e shkëputjes nga detyra, duke zbritur shtesën për vështirësi.

2. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që dërgohen për studime dhe specializim në institucione arsimore jashtë vendit përfitojnë pagë, për periudhat respektive, në masën si më poshtë vijon:

a) deri në 6 (gjashtë) muaj, pagën e plotë për funksion (gradë);

b) mbi 6 (gjashtë) muaj, por deri në 2 (dy) vjet, pagën për funksion (gradë) që ka pasur në çastin e shkëputjes nga detyra, duke zbritur shtesën për vështirësi.

3. Ushtarakëve që përfshihen në shkronjën "b" të pikës 2 u jepet paradhënie në masën 3 (tre) paga mujore.

4. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Kur ushtaraku aktiv nuk pranon të kthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në detyrën e re që emërohet, ai detyrohet t'i dëmshpërblejë institucionit shpenzimet e bëra për studimin apo specializimin e tij.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.295, datë 18.7.1964 i Këshillit të Ministrave "Mbi dhënien e shpërblimit familjeve të punonjësve dhe ushtarakëve aktivë, që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime", ndryshuar me vendimin nr.55, datë 8.4.1970 të Këshillit të Ministrave, nuk zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 371, datë 23.7.2002**

**PËR HAPJEN E FAKULTETIT EKONOMIK NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR  
XHUVANI" NË ELBASAN, DUKE FILLUAR NGA VITI AKADEMIK 2002-2003.**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikës e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e fakultetit ekonomik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, duke filluar nga viti akademik 2002-2003.
  2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
  3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për miratimin e strukturës organike të këtij fakulteti dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**VENDIM**  
**Nr. 374, datë 23.7.2002**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË  
PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E CËRRIKUT**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Cërrikut, në Qarkun e Elbasanit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Cërrikut.
3. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masave përkatëse që paraqiten në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqen e përgjithshme 4022 m<sup>2</sup> tokë arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 011 000 (dy milionë e njëmbëdhjetë mijë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën 163 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Bashkinë e Cërrikut, e cila të kryejë dhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 24 korrik deri në 1 gusht 2002.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Financave dhe Prefektura e Qarkut të Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Pandeli Majko**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E  
VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E CËRRIKUT**

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë
1	Faik Sali Kamami	1000	500	500 000
2	Shyqyri Haziz Kamami	1640	500	820 000
3	Mahmut Ibrahim Kamami	1382	500	691 000
SHUMA		4022		2 011 000

**VENDIM  
Nr. 375, datë 23.7.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.278, DATË  
20.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 3 e vendimit nr.153, datë 7.4.2002 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.278, datë 20.6.2002 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"3.1. Leja e drejtimit të motomjeteve dhe automjeteve prodhohet me material plastik, polikarbonat, në përmasat 85.6 x 54.0 x 0.7 mm , me ngjyrë mbizotëruese rozë.

3.2. Leja e drejtimit të motomjeteve dhe automjeteve përmban elemente të domosdoshme vizuale dhe elemente të tjera, të kontrollueshme me mjete të posaçme, si më poshtë vijon:

a) emrin, mbiemrin, fotografinë dhe shenjat daktiloskopike të zotëruesit të kartës, të gdhendura me dëgjie me rreze lazer;

b) mikroçip;

c) barkod;

ç) variabël optik (i vendosur në njërën anë);

- d) printim ultraviolet (në njërën anë);
- dh) mikrotekst (në njërën anë);
- e) strukturë të ndryshme sipërfaqësore;
- ë) konture me printim të imët (printim guillosh);
- f) printim me ngjyrat e ylberit (në njërën anë).

3.3. Në mikroçip dhe barkod vendosen të dhënat e koduara me të dhënat e lejes së drejtimit.

3.4. Shtesat në elementet e sigurisë dhe në të dhënat e tjera, të pandryshueshme dhe të ndryshueshme, të domosdoshme për verifikim nga organet përgjegjëse, që vendosen në mikroçip dhe barkod përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Rendit Publik.

3.5. Modalitetet e prodhimit të lejes së drejtimit përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Rendit Publik.

3.6. Brenda datës 15 shtator 2002 të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, modeli përfundimtar (specimen) i lejes së drejtimit. "

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko

**VENDIM**  
**Nr. 376, datë 23.7.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.406, DATË 17.8.1993 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE",**  
**NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.9, DATË 12.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50 të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 5 e vendit nr.405, datë 17.8.1993 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.9, datë 12.1.2001 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Pagesat për regjistrimin e PMB-ve bëhen nga subjektet e interesuara, në llogarinë rrjedhëse të Institutit të Mbrojtjes së Bimëve, siaps tarifave të përcaktuara në vendimin nr.72, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së produkteve për mbrojtjen e bimëve".

Me të ardhurat e realizuara nga këto pagesa, Instituti i Mbrojtjes së Bimëve përballon shpenzimet administrative të regjistrimit të PMB-ve, shpenzimet për analizat cilësore të tyre gjatë procedurave të regjistrimit dhe, pas hedhjes në treg, shpenzimet për kryerjen e provave biologjiko - agronomike dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve, sipas përcaktimit që bën Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit me udhëzim të veçantë. "

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Pandeli Majko

**VENDIM**  
**Nr. 382, datë 23.7.2002**

**PËR SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE NË FUSHËN E STANDARDEVE DHE TË RREGULLAVE TEKNIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- Me "standard" kuptohet një specifikim teknik, i miratuar nga organizimi kombëtar i standardizimit për përdorim të vazhdueshëm, zbatimi i të cilit nuk është i detyrueshëm dhe që shërben si dokument për arritjen e nivelit të cilësisë.

- Me "rregull teknik" kuptohen aktet nënligjore, me karakter teknik, të cilat përcaktojnë karakteristikat e produkteve ose proceset e prodhimit të tyre, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen për shkeljet. Ato mund të përmbajnë edhe kërkesat që kanë të bëjnë me terminologjinë, simbolet, paketimin, marketimin ose etiketimin, kur bëhet fjalë për një produkt ose proces prodhimi.

- Rregullat teknike përfshijnë:

a) rregullat administrative të një shteti anëtar, të cilat u referohen specifikimeve teknike dhe kërkesave të tjera ose rregullave mbi shërbimet, kodeve profesionale, si dhe kodeve të praktikës, të cilët nga ana e tyre u referohen specifikimeve teknike ose kërkesave të tjera, të cilat përputhen me detyrimet e vendosura në rregullat administrative të sipërpërmendura;

b) marrëveshjet vullnetare, të cilat një autoritet publik është një palë kontraktuese dhe që parashikojnë, në interes të publikut, përputhjen me veçoritë teknike ose kërkesa të tjera, duke përjashtuar veçoritë e prokurimit të tenderit publik;

c) "Specifikime teknike" janë specifikimet e dhëna në një dokument, të cilat japin karakteristikat e kërkuara për një produkt, si: niveli i cilësisë, vetitë, siguria, përmasat, duke përfshirë edhe terminologjinë, simbolet, provat, metodat e analizave, paketimin dhe etiketimin e produktit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

- Me "projektstandard" kuptohet dokumenti që përmban tekstin e specifikimeve teknike për një subjekt të caktuar, i cili mund të miratohet, në përputhje me procedurën e standardeve kombëtare, kur ky, pas hartimit, qarkullon për shqyrtime dhe komente.

- Me "projektregull teknik" kuptohet teksti i një specifikimi teknik ose i një kërkesë tjetër a rregulli mbi shërbimet, ku përfshihen masat administrative, që synojnë ta venë atë në zbatim si një rregull teknik, kur teksti është në fazën e përgatitjes, pra mund t'i bëhen përmirësime të mëtejshme thelbësore.

- Me program standardesh" kuptohet një program pune i një organi të njohur zyrtarisht si organizëm standardizimi, i cili rendit temat për të cilat kryhet standardizimi.

- Me "produkt" kuptohet çdo produkt industrial dhe bujqësor, përfshirë edhe produktet e peshkut.

- Me "shërbim" kuptohet çdo shërbim, që jepet kundrejt një pagese, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe sipas kërkesës individuale të atij që e kërkon këtë shërbim.

- Me "rregulla mbi shërbimet" kuptohen kërkesat e përgjithshme, që lidhen me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së shërbimit sipas përkufizimit të mësipërm, në veçanti me dispozitat për ata që e ofrojnë këtë shërbim, të atyre që e kryejnë dhe të atyre që përfitojnë nga ky shërbim, duke përjashtuar çdo rregull, që nuk synon, në mënyrë të veçantë, shërbimet e përcaktuara në atë pikë.

- Me "kërkesa të tjera" kuptohen kërkesat përveç specifikimeve teknike, të cilat janë vendosur mbi një produkt për mbrojtjen e konsumatorit ose të mjedisit, që ndikojnë në ciklin e qarkullimit pasi produkti të jetë hedhur në treg. Të tilla janë kushtet e përdorimit, riciklimi, ripërdorimi ose prirja, kur mund të ndikojnë, në mënyrë sinjifikative, përbërjen ose natyrën e produktit ose vendosjen e tij në treg.

- Masa OBT/SPS - masa sanitare dhe fitosanitare, sipas marrëveshjes së OBT-së.

- Masa OBT/TBT - masa për barrierat teknike në tregti, sipas marrëveshjes së OBT-së.

- Shtet anëtar-vendet anëtare të cilët janë palë në marrëveshjen që krijoi Organizata Botërore të Tregtisë dhe vendet anëtare të BE-së.

2. Qendra e të dhënave dhe e shitjes së standardeve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS), janë pikë referimi për dhënie informacioni për standardet dhe rregullat teknike.

Qendra jep informacion edhe për anëtarësimin, me të drejta të plota apo në një nivel më të ulët, të organeve përkatëse të shtetit shqiptar në organizatat, ndërkombëtare dhe rajonale, të standardizimit dhe të atyre të vlerësimit të konformitetit.

Kjo qendër njofton Sekretariatit e Organizatës Botërore të Tregtisë në Gjenevë edhe për marrëveshjet, dy ose shumëpalëshe, për standardet, rregullat teknike a procedurat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë brenda kuadrit të marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë, kur kanë efekt të ndjeshëm në tregti.

3. Organet përkatëse shtetërore sapa të nisin përgatitjen e një standardi rregull teknik a procedure për vlerësimin e konformitetit, ose masa sanitare dhe fitosanitare, duhet të njoftojnë qendrën e informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit nëpërmjet grupeve ndërministrorë, të krijuara me urdhër të Kryeministrit.

I. Notifikimet sipas Marrëveshjes OBT/TBT dhe OBT/SPS

4. Informacioni duhet të përmbajë:

- bazën legjislative për përgatitjen e një standardi, rregull teknik, procedure të vlerësimit të konformitetit ose masa SPS;

- të dhëna për standardet europiane dhe ndërkombëtare, rregullat teknike, udhëzuesve dhe referencave, të cilat përbëjnë bazat për masat që propozohen;

- të dhëna për produktet dhe shërbimet e mbuluara, sipas masave që po përgatiten;

- qëllimet dhe arsyet për përgatitjen e këtyre masave;

- arsyet për çdo devijim nga dokumentet e mësipërme;

- një vlerësim që masat kanë kaluar procedurën e notifikimit, në përputhje me rregullat e OBT-së dhe BE-së.

Bashkëlidhur me informacionin duhet të jetë një projekt i masave që propozohen.

5. Notifikimi i masave shqiptare bëhet kur grupet ndërministrorë paraqesin një kërkesë të tillë. Në këtë rast qendra e kryen notifikimin dhe, në të njëjtën kohë, njofton organin përkatës shtetëror që ka propozuar masën për periudhën gjatë së cilës ajo nuk mund t'i miratojë masat në fjalë.

- Në rastin e një kërkesë të tillë, qendra duhet të njoftojë Sekretariatit e Organizatës Botërore të Tregtisë, në Gjenevë, nëpërmjet Misionit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara të Republikës së Shqipërisë, në Gjenevë, për masat që përgatiten. Qendra duhet të njoftojë organin, i cili ka bërë kërkesën për notifikim, se nuk duhet t'i adaptojë masat në fjalë 60 ditë pas ditës që Sekretariati i Organizatës Botërore të Tregtisë në Gjenevë ka marrë notifikimin.

- Qendra pasi merr komentet nga shtetet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë, nëpërmjet Sekretariatit të Organizatës Botërore të Tregtisë në Gjenevë ia dërgon ato organit që ka bërë kërkesë për notifikim.

- Qendra duhet të kërkojë, së fundmi, një projekt me komentet e pasqyruara, i cili duhet të përmbajë, në mënyrë të qartë, nëse komentet janë marrë ose jo parasysht, plotësisht ose pjesërisht, si dhe arsyet e mosmarrjes parasysht.

Përgjigja e plotë duhet t'u komunikohet anëtarëve të Organizatës Botërore të Tregtisë, të cilët kanë bërë komente për masat që po përgatiten.

6. Notifikimi i masave të huaja kryhet kur:

- Sekretariati i Organizatës Botërore të Tregtisë në Gjenevë i jep Misionit notifikimin e bërë nga anëtarët e tjerë të Organizatës Botërore të Tregtisë, i cili është i detyruar ta dërgojë atë menjëherë në Qendër.

Qendra një kopje të notifikimit e dërgon te grupi ndërmintor, përgjegjës për masat e propozuara.

- Kur grupi ndërmintor vlerëson se adaptimi i masave të propozuara nga një shtet anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë mund të shkaktojë një barrierë të panevojshme për tregun ndërkombëtar, ai njofton qendrën, ku jep shpjegim të vlerësimit dhe propozon ndryshimin e masave dhe, në raste të veçanta, mund të propozojë zgjatjen e periudhës së pushimit për adaptimin e masave në fjalë.

- Informacioni i plotë dërgohet nga qendra te shteti anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë, i cili ka dërguar notifikimin.

7. Të gjitha masat e këtij vendimi, që lidhen me procedurën e notifikimit duhen, gjithashtu, të zbatohen për çdo ndryshim ose përmirësim thelbësor të rregullave, për afatin e tyre dhe radhët e produkteve, për të cilat do të zbatohet.

II. Notifikimi sipas rregullave të Bashkimit Europian

8. Me hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Europian, rolin e Sekretarit të Organizatës Botërore të Tregtisë në Gjenevë për kryerjen e notifikimit e luan Komisioni Europian.

9. Notifikimi i standardeve kombëtare shqiptare sipas rregullave të BE-së kryhet kur organi kombëtar i standardeve, nëpërmjet qendrës, njofton Komisionin Europian dhe organet e standardeve se po përgatit ose përmirëson një standard kombëtar, me përjashtim kur ky ka të bëjë me adaptimin e një standardi të njëjtë, europian ose ndërkombëtar.

Përveç të dhënave të pikës 3, notifikimi duhet të bëjë të qartë nëse standardi në fjalë:

- do të adaptojë një standard ndërkombëtar, pa qenë i barazvlefshëm me të;

- do të jetë një standard i ri origjinal, kombëtar;

- do të përmirësojë një standard origjinal kombëtar.

10. Organi kombëtar i standardeve duhet të njoftojë Komisionin Europian për çdo masë të adaptuar në bazë të komenteve të tyre.

Me kërkesën e vendeve të BE-së, organi shqiptar i standardeve, gjatë përgatitjes së një standardi, duhet të lejojë pjesëmarrjen e një eksperti të BE-së. Është, gjithashtu, i dobishëm diskutimi për standardet në nivel europian, në përputhje me rregullat e organizmave europiane të standardizimit.

11. Organi kombëtar i standardeve nuk duhet të publikojë asnjë standard, i cili nuk e ka kaluar procedurën e notifikimit, në përputhje me pikat e këtij vendimi.

Ky organ nuk duhet të miratojë asnjë standard kombëtar, i cili nuk përputhet me një standard europian ekzistues.

12. Notifikimi i rregullave teknike shqiptare sipas rregullave të BE-së nuk duhet të kryhet për ato masa, në formën e rregullave, masave administrative ose marrëveshjeve vullnetare, me të cilat organet përkatëse:

- zbatojnë akte detyruese të Bashkimit Europian, të cilat rezultojnë me miratimin e veçorive teknike ose të rregullave mbi shërbimet;

- plotësojnë detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat rezultojnë në miratimin e specifikimeve teknike të përbashkëta ose rregullat mbi shërbimet brenda Bashkimit Europian;

- vënë në përdorim klauzola mbrojtëse të parashikuara në aktet detyruese të Bashkimit Europian;

- nxjerrin autorizime për miratimin e masave të jashtëzakonshme, në përputhje me rregullat e harmonizuara për sigurinë e përgjithshme të produktit;

- detyrohen për të zbatuar një gjykim të Gjykatës Europiane;

- detyrohen për të përmirësuar një rregull teknik, në përputhje me një kërkesë të Komisionit, për mënjanimin e barrierave në tregti ose për rregullat mbi shërbimet, për mënjanimin e barrierave të lëvizjes së lirë të shërbimeve ose për lirinë e krijimit të një furnizuesi shërbimi.

13. Kur organet përkatëse shtetërore përgatisin një rregull teknik duhet të njoftojnë, nëpërmjet qendrës, Komisionin Europian. Njoftimi duhet të përmbajë një përmbledhje të arsyeve për hartimin e këtij rregulli teknik dhe të komunikojë tekstin e të gjitha ligjeve dhe rregullave bazë, të cilat formojnë kuadrin ligjor brenda të cilit projektregulli teknik do të zbatohet, kur kjo është e nevojshme për vlerësimin e pasojave të tij.

Në qoftë se projektregulli teknik është thjesht një zhvendosje e tekstit të plotë të një standardi ndërkombëtar ose europian, nuk është e nevojshme procedura e mësipërme.

Të dhënat duhen të jenë të një natyre konfidenciale vetëm nëse organi që ka kërkuar notifikimin ka parashtruar një kërkesë të arsyetuar për këtë qëllim.

14. Kur organet përkatëse shtetërore botojnë një rregull teknik, i cili është subjekt për t'u notifikuar nga Komisioni Europian, ky rregull teknik duhet të deklarojë se të gjitha kërkesat e udhëzimit, që përcaktojnë procedurën e informacionit në fushën e standardeve, rregullave teknike dhe rregullave mbi shoqërinë e informacionit, janë plotësuar. Në të kundërt ajo duhet të shoqërohet nga një pohim i tillë në një botim zyrtar.

15. Kur një projektregullore teknike kërkon të kufizojë hedhjen në treg ose përdorimin e substancave të produkteve kimike, duke patur parasysh sigurinë e shëndetit publik të konsumatorit dhe mbrojtjen e mjedisit, organet përkatëse shtetërore që e propozojnë këtë projektregull duhet të shpërndajnë te Komisioni Europian një përmbledhje ose referenca me të gjitha të dhënat përkatëse.

Përveç këtij informacioni, duhet një shpjegim i pasojave që mund të ketë për sigurinë e shëndetit publik, të konsumatorit dhe mbrojtjen e mjedisit hedhja në treg e një produkti kimik.

16. Në qoftë se Komisioni Europian ose ndonjëra nga shtetet anëtare dërgojnë komente për projektregulloret teknike, këto komente, nëpërmjet qendrës, kalojnë tek organi përkatës shtetëror, që ka propozuar projektregullin teknik, që këto komente të merren parasysh në përgatitjen e mëtejshme të këtij rregulli teknik. Teksti përfundimtar me komentet e pasqyruara i komunikohet Komisionit Europian nëpërmjet Qendrës.

17. Organet përkatëse shtetërore duhet të botojnë një projektregullore teknike vetëm tre muaj pasi Komisioni Europian ta ketë marrë notifikimin.

18. Në qoftë se Komisioni Europian ose ndonjëra nga shtetet anëtare kanë dërguar, brenda tre muajve nga data e marrjes së notifikimit, komentet se masat e propozuara, një rregull teknik, në formën e një marrëveshjeje vullnetare, apo çdo rregull tjetër teknik (me përjashtim të atyre që përmbajnë vetëm rregullat mbi shërbimet), mund të krijojnë barriera për lëvizjen e lirë të mallrave në tregun e brendshëm, atëherë organi propozues nuk duhet t'i miratojë ato para një afati kohor prej 4 ose 6 muajsh nga dita e dhënies së komenteve.

19. Organet përkatëse shtetërore nuk duhet të miratojnë asnjë rregull teknik që përmban rregulla mbi shërbimet, pa kaluar 4 muaj nga data e marrjes së notifikimit nga Komisioni Europian, nëse ndonjëra nga shtetet anëtare ka dërguar, brenda tre muajve, komente se masat e propozuara mund të shkaktojnë barriera për lëvizjen e lirë të shërbimeve në tregun e brendshëm.

20. Organet përkatëse shtetërore, nëpërmjet qendrës, duhet të raportojnë te Komisioni Europian për masat që ato planifikojnë të miratojnë, sipas komenteve të marra. Për rregullat teknike që përmbajnë rregullat mbi shërbimet, organi që propozon masat duhet, si rregull, të deklarojë arsyet nëse nuk merr parasysh komentet e bëra.

21. Organet përkatëse shtetërore nuk mund të botojnë një rregull teknik, pa kaluar 12 muaj nga dita e marrjes së notifikimit, nëse Komisioni Europian ka botuar:

- qëllimet e veta për të propozuar ose zbatuar një udhëzim, rregull ose vendim në të njëjtën fushë, në përputhje me procedurën që përmban neni 189 i Marrëveshjes së Komisionit Europian (me përjashtim të kërkesës për akte të cilat përmbajnë vetëm rregulla mbi shërbimet);

- vendimet që projektregullorja teknike lidhet me një subjekt të diskutuar sipas një projektudhëzimi, rregulli ose vendimi të parashtruar në Këshillin e Bashkimit Europian, në përputhje me procedurën që përmban neni 189 i Marrëveshjes së Komisionit Europian.

Në qoftë se Këshilli ka miratuar një pozicion të përbashkët, për periudhën gjatë së cilës nuk mund të zbatohen masat e propozuara, kjo periudhë duhet të shtyhet deri në 18 muaj.

22. Detyrimet që rrjedhin nga neni 189 marrin fund:

- kur Komisioni Europian njofton Republikën e Shqipërisë se nuk ka qëllime të mëtejshme për të propozuar ose zbatuar një akt detyrues;

- kur Komisioni Europian njofton Republikën e Shqipërisë për shfuqizimin e projektit a të propozimit të tij;

- kur Komisioni Europian ose Këshilli kanë adaptuar një akt komunitar detyrues;

23. Rregullat e parashikuara në pikat 13-23 të këtij vendimi nuk zbatohen në rastet kur:

- për arsye urgjente, të shkaktuara nga rrethana serioze dhe të paparashikuara për mbrojtjen e shëndetit publik ose sigurinë, mbrojtjen e kafshëve ose mbrojtjen e bimëve, në rregullat teknike mbi shërbimet ato për mbrojtjen e të miturve, Shqipëria është e detyruar të përgatisë rregulla teknike në një hapësirë shumë të shkurtër kohore, për t'i nxjerrë dhe zbatuar ato menjëherë, pa ndonjë këshillim paraprak të mundshëm;

- për arsye urgjente, të shkaktuara nga rrethana serioze për mbrojtjen dhe sigurinë e integritetit të sistemit financiar, për mbrojtjen e depozituesve, investitorëve dhe personave të siguruar, Shqipëria është e detyruar të urdhërojë dhe të zbatojë rregullat për shërbimet financiare.

Në notifikim, organi përkatës shtetëror, që propozon masat, duhet të japë arsyet për urgjencën e masave të marra.

24. Notifikimi i masave të huaja, sipas rregullave të BE-së , kryhet sipas kësaj procedure:

Qendra duhet të trajtojë notifikimet e marra për masat që janë duke u përgatitur nga shtetet e tjera anëtare ose organet e tyre të standardizimit me një kërkesë, në përputhje me pikën 5 të këtij vendimi, me përjashtim të masave për zgjatjen e kohës për negociatat ndërkombëtare. Për paraqitjen e ndonjë komentit për masat që përgatiten, duhet të kihet parasysh periudha e pushimit prej tre muajsh.

Kur ndonjë shtet tjetër anëtar përcakton masat e notifikuara si konfidenciale, atëherë organet përkatëse të shtetit, duke vlerësuar masën, mund të përfshijnë persona, juridikë dhe fizikë, nga sektori privat në punën e ekspertëve, vetëm nëse merren masa të nevojshme për sigurimin e konfidencialitetit.

Çdo koment për specifikimet teknike, kërkesat e tjera apo rregullat, duhet t'u përkasin vetëm atyre aspekteve që mund të shkaktojnë pengesa për tregun, ndërsa çdo koment për rregullat mbi shërbimet duhet t'i përkasë vetëm lëvizjes së lirë të shërbimeve ose lirisë së krijimit të një furnizuesi shërbimi, por jo aspektit fiskal dhe financiar të kësaj mase.

Çdo koment për rregullat teknike, që përmban rregullat mbi shërbimet, nuk do të zbatohet për asnjë politikë kulturore masash, veçanërisht për fushën audio-vizuale, të cilat shtetet anëtare të bashkimit Europian e miratojnë, në përputhje me ligjet e veta, duke marrë parasysh ndryshimet e tyre gjuhësore, veçoritë kombëtare dhe karakteristikat rajonale.

III. Masa kalimtare dhe përfundimtare

25. Rregullat e parashikuara në pikat 9 deri 25 të këtij vendimi fillojnë të zbatohen në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian ose me hyrjen në fuqi të ndonjë marrëveshjeje të veçantë ndërmjet palëve të lartpërmendura për procedurat e notifikimit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike, cilado që të jetë më e afërta në kohë.

26. Vendimi nr.372, datë 24.8.1999 i Këshillit të Ministrave "Për shkëmbimin e informacionit për standardet dhe rregullat teknike" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 1.8.2002  
Doli nga shtypi më 2.8.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë